

V E N D I M
Nr. 211, datë 16.5.2002

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMN NR.508, DATË 8.11.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME KONCESION TË UZINËS SË
FERROKROMIT ELBASAN DHE MINIERAVE TË KROMIT PËRRENJAS DHE POJSKË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16 të ligjit nr. 7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në vendimin nr. 508, datë 8.11.1999 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

1. Pas pikës 3 shtohet pika 3.1, me këtë përmbajtje:

“3.1. Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe Energjetikës për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj kontrte.”.

2. Pika 4 ndryshon si më poshtë vijon:

“4. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtre.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko